



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
NDËRMARRJA E PASURISË PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

NR ___/prot

DATA: ___/___/2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje beton dhe zgara hekuri”- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj,ndarë në 2 lote:

LOTI 1 – Beton C-16/20 (Me zall) >

LOTI 2 – Hekur betoni i zakonshëm Ø 6 - 10 mm² >

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Beton 44114000-2

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 34,661,253.89(tridhjetë e katër milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre pikë tetëdhjetë e nëntë) LEKË PA TVSH, i ndarë në 2 lote:

LOTI 1 –Beton C-16/20 (Me zall)- 24,140,505.22(njëzetë e katër milionë e njëqind e dyzetë mijë e pesëqind e pesë pikë njëzetë e dy)LEKË PA TVSH.

LOTI 2 – Hekur betoni i zakonshëm Ø 6 - 10 mm² > - 10,520,748.66(dhjetë milionë e pesëqind e njëzetë mijë e shtatëqind e dyzetë e tetë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) LEKË PA TVSH.

Vlera e fondit limit është perlloritur duke u bazuar në:

-Ligjin Nr.8402,datë:10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”;

-VKM-së Nr.216,datë:13/04/2023“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të cmimeve për zërat e punimeve”;

-Udhëzimin Nr.02,datë:08/05/2003“Për klasifikimin dhe struktuerën e kostos së punimeve të ndërtimit”,konform nenit 34, 35 dhe 36 të Ligjit Nr 162/2021 “Për Prokurimin Publik”.

Vënë në dispozicion nga:

Buxheti i shtetit – 16,666,666.67(gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) LEKË PA TVSH.

Vetëfinancim – 17,994,587.22(shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë njëzetë e dy) LEKË PA TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti/enti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

ARGUMENTIMI: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76 ”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- EN-ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë(në lidhje me objektin e tenderit).
- EN-ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga OrganizmaNdërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

ARGUMENTIM: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

EN-ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

EN-ISO 14001:2015 Kërkesa për certifikimin sipas ISO 14001 është vendosur për të garantuar që operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurë zbatojnë standarde të njohura ndërkombëtarisht për menaxhimin e ndikimit në mjedis.

Procesi i prodhimit dhe furnizimit të betonit përfshin aktivitete që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis, si përdorimi i inerteve, emetimet e pluhurit, zhurmat, si dhe menaxhimi i mbetjeve industriale. Në këtë kuadër, kërkohet që operatorët ekonomikë të disponojnë një sistem të strukturuar për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e këtyre ndikimeve.

Zbatimi i standardit ISO 14001 siguron që operatori ekonomik:

- vepron në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi;
- kontrollon dhe minimizon ndotjen gjatë prodhimit dhe transportit të betonit;
- ndjek politika të qëndrueshme në përdorimin e burimeve natyrore;

- garanton monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës mjedisore.

Vendosja e kësaj kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e kontratës dhe është proporcionale me objektin e prokurimit, pasi synon të sigurojë furnizim me beton nga operatorë që respektojnë standardet mjedisore dhe reduktojnë ndikimet negative në ambient.

Per sa i perket zgarave te hekurit,ky certifikim eshte kerkuar duke marrë në konsideratë se prodhimi i zgarave te hekurit përfshin procese industriale me ndikim të konsiderueshëm në mjedis, si:

- emetimet në ajër gjatë përpunimit
- konsumi i lartë i energjisë;
- gjenerimi i mbetjeve industriale.

Në këtë kuadër, kërkohet që prodhuesi të zbatojë një sistem të menaxhimit mjedisor që garanton:

- kontrollin dhe reduktimin e ndikimeve negative në mjedis;
- respektimin e legjislacionit mjedisor në fuqi;
- përdorimin e praktikave të qëndrueshme në prodhim.

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Kopje te deklaratave te xhiros vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar te kontrates.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" në të cilin gjejmë te përcaktuar se: " Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës", në pikat 1,2 (b) ,3 të nenit 43, si dhe në nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se

zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic ëshët parashikuar nga AK. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,. Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025, të konfirmuara nga organet tatimore, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar me Ligjin Nr.47/2016, datë 28.04.2016, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, "Gjithashtu Autoritetet ose Entet Kontraktore mund të kërkojnë që Operatorët ekonomik të japin informacione në Bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit" LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me ligjin Nr.95/2023,date:07/12/2023, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic ëshët parashikuar nga AK.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së

njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

LOTI 1 – Beton C-16/20 (Me zall) >

2.3.2 Nëse Ofertuesi është prodhues, atëherë ai duhet të paraqesë, lejen mjedisore, dokumentacionin e pronësive ose qerese se impjantit të prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 40, pika 5, germa “ç” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteri 2.3.2 është vendosur për të garantuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë disponojnë kapacitetin teknik dhe ligjor për furnizimin e materialeve objekt prokurimi, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në rastin e furnizimit me beton, kërkesa për disponimin e impjantit të prodhimit ose dokumentacionit që vërteton aksesin në të është e domosdoshme për të siguruar:

- prodhim sipas standardeve teknike;
- furnizim të vazhdueshëm dhe në kohë;
- kontroll të cilësisë së materialit.

Gjithashtu, kërkesa për leje mjedisore sipas legjislacionit përkatës dhe akteve nënligjore, vendoset për të garantuar që operatori ushtron aktivitetin në mënyrë të ligjshme dhe sipas standarteve të njohura ndërkombëtarisht për menaxhimin e ndikimit në mjedis.

Ose

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, për mallin objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Në rastin kur, operatorët ekonomikë kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë: 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Ky kriter është vendosur për të garantuar sigurinë e origjinës dhe cilësisë. Autorizimi provon që ofertuesi furnizohet nga burim zyrtar dhe se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit të ofertuar. Gjithashtu autorizimi është kërkuar dhe për t’i dhënë siguri AK-së se mallrat e ofertuar i përmbushin specifikimet teknike të kërkuara.

Ky kriter është në përpjesëtim me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi lejon pjesëmarrjen si të prodhuesve ashtu edhe të distributorëve të autorizuar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallin objekt prokurimi, raportin e testimit ose/dhe raportin e analizave ose/dhe skedë teknike, ku të pasqyrohen të gjitha karakteristikat e produktit, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

ARGUMENTIMI: Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligji nr. 162/2020 dhe pikës 6/c të nenit 40 të VKM nr. 285/2021, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë nga operatorët ekonomikë paraqitjen e dokumentacionit teknik që vërteton përputhshmërinë e mallrave me specifikimet e kërkuara.

Në këtë kuadër, kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë raport testimi dhe/ose raport analizash dhe/ose skedë teknike për mallin objekt prokurimi vendoset për të garantuar që produkti i ofruar përmbush të gjitha karakteristikat teknike dhe standardet e kërkuara në DST.

Ky dokumentacion i shërben autoritetit kontraktor për:

- verifikimin objektiv të cilësisë së materialeve;
- krahasimin e ofertave mbi baza teknike;
- sigurimin që malli i ofertuar është në përputhje me standardet përkatëse.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjete transporti për furnizimin me beton të përshtatshme për operim në kushte terreni të vështirë (rrugë të ngushta, pjerrësi, terren i paaksesueshëm lehtësisht), në pronësi, qira, ose kontrate bashkëpunimi.

Mjetet duhet të garantojnë shpërndarjen e betonit në cilësi dhe në kohë, pa cenuar karakteristikat teknike të tij.

ARGUMENTIMI: Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligji nr. 162/2020 dhe pikës 5/ç të nenit 40 të VKM nr. 285/2021, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë nga operatorët ekonomikë disponimin e mjeteve dhe kapaciteteve teknike të nevojshme për realizimin e kontratës.

Në këtë kuadër, kërkesa që operatori ekonomik të disponojë mjete transporti të përshtatshme për furnizimin me beton në kushte terreni të vështirë vendoset duke marrë në konsideratë natyrën specifike të objektit të prokurimit dhe kushtet reale të zbatimit të kontratës.

Transporti i betonit paraqet veçanti teknike, pasi:

- betoni është material që duhet të transportohet dhe të vendoset brenda një kohe të kufizuar;
- transporti i papërshtatshëm ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e tij;
- kushtet e terrenit (rrugë të ngushta, pjerrësi, akses i kufizuar) kërkojnë mjete specifike dhe të përshtatura.

Në këtë kuadër, disponimi i mjeteve të tilla garanton:

- furnizim në kohë dhe pa ndërprerje;
- ruajtjen e karakteristikave teknike të betonit gjatë transportit;
- realizimin e kontratës sipas standardeve teknike dhe kushteve të punimeve.

Gjithashtu, kriteri është në përpjesëtim me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi lejon që operatorët ekonomikë t'i disponojnë këto mjete si në pronësi, ashtu edhe me qira apo nëpërmjet kontratave të bashkëpunimit.

LOTI 2 – Hekur betoni i zakonshem Ø 6 - 10 mm² >

2.3.6 Operatori ekonomik, në rast se është prodhues duhet të disponojë ambient prodhimi në pronësi ose me qira, i vertetuar me dokumentacionin e pronësive ose qerave.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë leje mjedisore të vlefshme për aktivitetet e prodhimit/përpunimit të materialeve metalike, nëse aktiviteti i tij i nënshtrohet pajisjes me leje sipas legjislacionit në fuqi, ose deklaratë që nuk i nënshtrohet këtij detyrimi.

Në rast se operatori ekonomik është tregtar ose i autorizuar, duhet të paraqitet leja mjedisore e prodhuesit.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 40, pika 5, germa “5/ç” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ky kriter eshte vendosur me qellim qe operatori ekonomik t’i provoje Autoritetit Kontraktor se zoteron pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Gjithashtu, kërkesa për leje mjedisore sipas legjislacionit përkatës dhe akteve nënligjore, vendoset për të garantuar që operatori ushtron aktivitetin në mënyrë të ligjshme dhe sipas standarteve të njohura ndërkombëtarisht për menaxhimin e ndikimit në mjedis.

Kriteri është në përpjesëtim me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi lejon operatorët ekonomikë që në rast se janë tregtar ose të autorizuar, majfton të paraqesin lejen mjedisore të prodhuesit.

Ose

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, për mallin objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Në rastin kur, operatorët ekonomikë kanë kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet kontrata e vlefshme e furnizimit.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë: 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Ky kriter është vendosur për të garantuar sigurinë e origjinës dhe cilësisë. Autorizimi provon që ofertuesi furnizohet nga burim zyrtar dhe se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit të ofertuar. Gjithashtu autorizimi është kërkuar dhe për t’i dhënë siguri AK-së se mallrat e ofertuar i përmbushin specifikimet teknike të kërkuara.

Ky kriter është në përpjesëtim me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi lejon pjesëmarrjen si të prodhuesve ashtu edhe të distributorëve të autorizuar.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton transportin e mallin objekt prokurimi në adresën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë

kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Ky deklaram kërkohet për t’i vërtetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi gjithashtu edhe sepse AK nuk ka parashikuar kosto të tjera shtesë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit të përcaktuar në kërkesën për dorëzim dokumentacioni pranë AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 të VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

ARGUMENTIM I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE - Projekti, Preventivi, Specifikimet teknike, Relacioni Teknik janë sipas materialit i cili është publikuar sëbashku me dokumentet e tenderit të hartuara nga specialistët e fushës, pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Lushnjë, në përputhje me detyrat funksionale që ajo ushtron

Specifikimi i Materialeve:

Vendim Nr.568,date:27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”

NJËSIA E PROKURIMIT